



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI I ARTEVE
SENATI AKADEMIK

VENDIM

Nr. 5, datë 23.01.2019

MBI

“SHPLLJEN E ZGJEDHJEVE TË REJA, PËR 2 VËNDE VAKANTE, PËR ANËTAR TË SENATIT AKADEMIK, KATEGORIA STUDENT, NË UNIVERSITETIN E ARTEVE”

Senati Akademik i Universitetit të Arteve, në mbledhjen e datës 23.01.2019, mbështetur në ligjin nr. 80/2015, datë 22.07.2015 për “Arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”; Vendimin e Senatit Akademik nr. 4, datë 23.01.2019 “Për zgjedhjen e anëtarëve të Komisionit Institucional të Zgjedhjeve (KIZ), në Universitetin e Arteve”; Rregulloren e Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë me nr. 2459/1 prot., datë 15.03.2016 “Për organizimin e zgjedhjeve të para për autoritetet dhe organet drejtuese në Institucionet Publike të Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë” si dhe duke marrë në konsideratë se anëtarët aktual të Senatit Akademik, kategoria student, kanë përfunduar studimet në UART dhe për këtë arsye,

VENDOSI:

1. Shpalljen e zgjedhjeve të reja për 2 (dy) vende vakante, për anëtar të Senatit Akademik, kategoria student, në Universitetin e Arteve.
2. Ngarkohet Komisioni Institucional i Zgjedhjeve (KIZ) në Universitetin e Arteve, i zgjedhur me Vendimin e Senatit Akademik nr. 4, datë 23.01.2019 “Për zgjedhjen e anëtarëve të Komisionit Institucional të Zgjedhjeve (KIZ), në Universitetin e Arteve”, të marrin masat e nevojshme për miradministrimin e procesit zgjedhor në UART.
3. Ngarkohet Komisioni Institucional i Zgjedhjeve (KIZ), që brenda datës 22.02.2019 të ketë përfunduar procesi zgjedhor për 2 vendet vakante, anëtar Senatit Akademik, kategoria student.
4. Ky vendim ti dërgohet Komisionit Institucional të Zgjedhjeve (KIZ).
5. Ky vendim të shpallet në faqen zyrtare të Universitetit të Arteve.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

SENATI AKADEMIK I UNIVERSITETIT TË ARTEVE

Prof. Kastriot ÇAUSHI

Prof. Dr. Zana SHUTERIQI (PRELA)

Prof. Dr. Isak SHEHU

Prof. Petrit MALAJ



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Prof. Asoc. Ardian ISUFI

Prof. Sadik SPAHIJA

Prof. Vladimir MYRTEZAJ (GROSHA)

Prof. Najada HAMZAJ

Prof. Fatmir MIZIRI

Prof. Ilir MARTINI

Prof. Gazmend GJOKA

Prof. Miltiadh KUTALI

Prof. Petrika AFEZOLLI

Prof. Bujar SYKJA

Prof. Dr. Erald BAKALLI

Prof. Asoc. Elvis RUDI

ProfAsoc. Albes FUSHA